



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA E KLINËS

KUVENDI I KOMUNËS

Nr. 01 / 06 - 4555115

Klinë, 24.9.2014

PROCESVERBAL

I DEBATIT ME PUBLIKUN, MBAJTUR, MË 24.9.2014, NË ORËN 10.00,
NË SALLËN E KK

Në debat morën pjesë: Kryetari i Komunës, z. Sokol Bashota, nënkyretari i Komunës, z. Enver Berisha, Kryesuesi i Kuvendit, dr. Haxhi Ibishi, drejtorët e Ekzekutivit, OSBE, Zyra ligjore, OJQ-yë, Zyra për Informim, mediet dhe publiku.

Dabtin e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë debat. Në vijim kryesuesi Ibishi shprehi pakënaqësinë për numrin jo të madh të qytetarëve në këto debate me publikun. “Nuk jemi të kënaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve. Vërejtjet, sugjerimet, propozimet dhe priorititetet e qytetarëve duhet të prezantohen në kësot debatesh, sepse zërin e qytetarëve duhet ta dëgjojë pushteti lokal i Komunës”, shtoi kryesuesi Ibishi, i cili në vijim njoftoi pjesëmarrësit që debati organizohet nga Kuvendi i komunës dhe Ekzekutivi.

Kryesuesi Ibishi prezantoi pikat e propozuar në këtë debat.

RENDI I DITËS

1. Draf-programi trevjeçar i banimit social për periudhën 2014-2016,
2. Shqyrtimi i Projekt-buxhetit të Komunës për vitin 2015-2017.

Pika e parë: Draft-programi trevjeçar i banimit social për periudhën 2014-2016.

Haxhi Ibishi, foli rrëth pikës së parë të rendit të ditës. “Është një draft – program trevjeçar i banimit social për periudhën 2014-2016”, shtoi kryesuesi, i cili në vijim fjalën e barti të zyrtari i lartë i Drejtorisë për Urbanizëm, z. Ali Gashi.

Ali Gashi, zyrtar i lartë i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtjet të Mjedisit në mënyrë kronologjike raportoi rrëth Draft-programit trevjeçar të banimit social për periudhën 2014-2016.

Prezantimi i zyrtarit Gashi, u bë përmes shumë sqarimeve të këtij draft-programi, po ashtu edhe përmes teknikës së monitorit.

Pas përfundimit të raportimit, kryesuesi Ibishi hapi debatin rreth këtij draft-buxheti.

Nuk pati debate nga ana e qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjera.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Projekt-buxhetit të Komunës për vitin 2015-2017.

Kryesuesi Ibishi foli rreth pikës së propozuar të rendit të ditës. “Është një kornizë trevjeçare e buxhetit komunal 2015-2017”. Fjalën e barti të drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Ramiz Rrusta, raportoi në mënyrë kronologjike rreth Projekt-buxhetit të Komunës për vitin 2015-2017. “Buxheti komunal për vitin 2015 është rreth 2 milionë euro. Kemi kornizën buxhetore ku nuk kemi mundësi të dalim jashtë saj. Janë 2 milionë euro të cilat mund t’i shfrytëzojmë. Të merret parasysh që me këtë vlerë të caktuar sa kemi mundësi të bëjmë. Kryetari e ka potencuar se ato vendbanime të cilat participojnë në vlerën prej 25 për qind kanë përparësinë për t’u investuar dhe ato projekte do të realizohen”, shtoi ndër të tjera drejtori Rrusta. Drejtori Rrusta, në vijim prezantoi të gjitha projektet prioritare për vitin 2015.

Haxhi Ibishi, hapi debatin.

Xhavit Hoti- Jashanicë, prezantoi shqetësimin e tij që në projektet prioritare për vitin 2015 nuk është përfshirë asnjë projekt i fshatit Jashanicë, përpos 150 mijë eurove që janë ndarë për shkollat. “Jemi të anashkaluar si fshat”, shtoi z. Hoti.

Arif Elezi, prezantoi kërkesat e qytetarëve të fshatit **Gjurgjevik i Vogël**: Kanalizimin, rrugën që shpie në drejtim të Kërnicës dhe çështjen e qenve endacakë, të cilët rrezikojnë fëmijët dhe banorët e fshatit.

Lutë Halitaj, nga Jashanica e Epërme, kërkoi shtruarjen e rrugës pre 1 km që lidhet me lagjen Ballaku. Më pastaj z. Halitaj prezantoi edhe çështjen e rrymës, ujet të pijshëm dhe kanalizimit. “Lagja jonë është anashkaluar. Kontributi ynë dihet: kemi 12 veteranë të luftës dhe 2 dëshmorë të kombit”, shtoi ai.

Isa Morina, Grabanicë, shtroi çështjen e kanalizimit në një pjesë të fshatit të Grabanicë. “Një pjesë është rregulluar në fazën e parë, ndërsa pjesa tjetër nuk është rregulluar. Në vijim ai prezantoi 3 kërkesa: Mungesen e shtyllave elektrike (të vjetruara), po ashtu rrjeti i dobët, mungesa e ujit të pijshëm, po ashtu edhe sigurimi i serave do të ishte e nevojshme pasi që në këtë fshat ka ujë për ujite.

Isuf Gashi, nga Resniku, prezantoi nevojën e një rruge 200 metra dhe të kanalizimit.

Sejdi Baleci, sqaroi rregullimin e fazës së parë të kanalizimit të fshatit Grabanicë. Në vijim z. Baleci ngrehi çështjen nevojës për ujet të pijshëm, po ashtu edhe të rrugës në gjatësi prej 800 metrave.

Agron Gashi, ne emër të OJQ “Koha” prezantoi disa projekte: Ndriçimin e rrugëve “Ali Kelmendi”, Bajram Curri” dhe “Hasan Prishtina”, funksionalizimin e ambulancës së fshati Leskoc, ku ka disa vite që objekti është ndërtuar, funksionalizimin e këshillave të fshatrave, faza e dytë e kanalizimit në Grabanicë dhe të shkollës në Këpuz, penda e ujitjes, rregullimin e shkoles në Grabanicë, po ashtu edhe si qytetar i fshatit të Sferkës kërkoj që rruga Sferkë – Përçevë të përfshihet në prioritete”, kërkoi z. Gashi.

Rexhë Krasniqi, prezantoi shqetësimin e tij për rregullimin e një rruge prej 100 metra në një lagje të qytetit të Klinës, e cila sipas tij është e pakalueshme.

Kamer Dauti, nga Shtupeli, prezantoi shqetësimin e tij për rregullimin e një rruge të fshatit të lagjes që i takon ai.

Ajet Delia, theksoi se lagja e fshatit Deiq ku ai i takon nuk ka as ujë as ujë.

Sokol Bashota, kryetar i Komunës, iu përgjigje interesimeve dhe kërkeseve të qytetarëve. Kryetari Bashota shtoi se kornizat buxhetore diktojnë shumë edhe në implementimin e shumë prioriteteve. Janë rrith 2 milion euro investime kapitale, dhe shpërndarja e tyre në 54 fshatra të Komunës, mund të merrni me mend se çfarë mund të bëjmë me këtë shifër të këtij buxheti”, shtoi kryetari Bashota, i cili në vijim foli rrith investimeve që Komuna ka bërë nëpër shkolla. “Tri objekte shkollore në komunën tonë në vlerë prej 1 milion euro, domethënë me gjysmën e buxhetit, kemi investuar. Kemi bërë që nxënësve tanë, fëmijëve tanë, që janë e ardhmja e këtij vendi t'u krijojmë kushte më të mirë për të marrë dije dhe dituri. Gjatë implementimit të projekteve kemi hasur në shumë pengesa nga qytetarët, edhe sot kemi 2 raste ku kemi pengesa në realizimin e projekteve, përkatesisht në shtrirjen e kanalizimeve. Bëj përpjekje për të qenë i barabartë për të gjithë. Pa marrë parasysh përcaktimin, qytetarët janë të barabartë, sepse i takojnë njëjtë këtij vendi dhe i konsiderojmë njëjtë. Pushtetin e keni krijuar ju qytetarët, me shumë gjak e sakrifica. Kurrë nuk jemi sjellë rrith këtij 2 milionshi, mirëpo kemi thithur donacione edhe nga bashkësia ndërkombëtare, mirëpo edhe nga Qeveria e Kosovës. Dikur kemi pasur nevojë të shtrojmë kilometra – kilometra rrugë, tash kjo gjatësi na ka ardhur në 100 metra. Kërkesa tuaja janë shumë të arsyeshme. Edhe ju tregoni vullnetin që dëshironi të realizoni projekte, rrugë, ujësjellës, kanalizime etj. Jepni gatishmërinë tuaj, edhe ne kemi për t'i realizuar ato projekte. Këto kërkesa tuaja do të hynë në Asamblenë komunale. U potencua, rryma, energjia, këto i ka marrë kompania private, nuk kemi qasje në atë drejtim. Kemi investuar 20 milionë në këtë drejtim. Kemi investuar për hir të qytetarëve, për mirëqenien e tyre. Nuk mund të anashkalojmë asnjë lokalitet, që së paku jepni 15 për qind të participimit në do t'i realizojmë ato projekte. Këtë vit realizojmë disa projekte në disa lokalitete, viteve të tjera në lokalitete të tjera dhe kështu me radhë. Kemi në plan për disa hapësira të gjelbëruara në Klinë, sepse qyteti ynë meriton të ketë më

shumë hapësira të gjelbëruara. Të jeni të sigurt se të gjitha këto që thuhen sot këtu, ku është e nevojshme do të realizojmë, kuptohet edhe me ndihmën tuaj. Kërkesat tuaja do t'i dërgoj në Asamblenë Komunale, anëtarët e Kuvendit do t'i adresojnë”, nën vizoi kryetari Bashota.

Kryesuesi Ibishi, falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e dhënë.

Debatin e konstatoi të mbyllur.

Debati përfundoi në orën 11.35 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel Gojani



Kryesuesi i Debatit,
Dr. Haxhi Ibishi